




GJYKATA SUPREME E KOSOVES

VRHOVNOG SUDA KOSOVA

DHOMA E POSACME

SPECIJALNA KOMORA

VERTETIMI MBI DOREZIMIN E DOKUMENTIT	POTVRDA O DOSTAVI DOKUMENTA	ACKNOWLEDGEMENT OF RECEIPT OF A DOCUMENT
--	-----------------------------------	--

Numëri i lëndës:	C-IV-22-0311	Data:	15.06.2026
Titulli i dokumentit		Data e dokumentit	
AKTVENDIM		12.06.2026	
		L.M	

Pala	AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT <i>Rr. Dritan Hoxha nr.55, Lakrishte, Prishtinë.</i>
Pranuar nga:	
Titulli:	
Data e pranimit:	
Nënshkrimi	

Zyrtare Ligjore





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO



Numri i lëndës: 2022:207077

Datë: 12.06.2026

Numri i dokumentit: 09032960

C-IV – 22-0311

Parashtruesi i kërkesës

Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, Autoriteti i Likuidimit për N.SH (N.B.I. Rahoveci”
Rahovec (në likuidim) Fi.492/89.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare
të Privatizimit (aplikim për të marr leje për heqje dorë nga aset), me gjyqtaren kryesuese Lirije
Maksutaj, dhe gjyqtarët anëtarë Asllan Krasniqi dhe Agron Hoxhaj, me 12.06.2026, merr këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet kërkesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në Prishtinë, Autoritetit të Likuidimit
për NSH “NBI RAHOVECI”, Rahovec dhe jepet pëlqimi Agjencisë të heq dorë nga aset ngastra
nr. P- 71510033-01623-0 , me sipërfaqe 7597 m², në dobi- pronësi të autoritetit publik Komuna
Rahovecit, në territorin e të cilin gjendjet ky aset .

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me datën 27.09.2022, Agjencia Kosovare e Privatizimit, ka ushtruar kërkesë në Dhomën e
Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për të marrë leje nga gjykata për të hequr dorë nga
aseti – aset ngastra nr. P- 71510033-01623-0 , me sipërfaqe 7597 m², zona kadastrale Xërxë,
komuna e Rahovecit, që është regjistruar në emër të NSH- ‘NBI Rahoveci’ Theksojnë se,

Numri i lëndës:
Datë:
Numri i dokumentit:



Autoriteti i Likuidimit tash ka shqyrtuar kërkesat e ushtruara në procedurë të likuidimit, dhe kërkesa mbështetet në dispozitën e nenit 18 paragrafi 3, i Ligjit nr. 04/L-034, për AKP-në . Parcela me numër 01623-0, me sipërfaqe 7597 m², zona kadastrale Xërxë, komuna e Rahovecit, është pronë e ndërmarrjes shoqërore, e cila është hequr nga shitja dhe është rast për heqje dorë për shkak të shfrytëzohet si si rajon ujor-lum në pellgun e lumit Drin ZK Xërxë.

Po ashtu është theksuar se, Autoriteti i Likuidimit arriti në përfundim se aseti në fjalë nuk është fitimprurës dhe tashme ka marrë miratimin nga Bordi i Drejtorëve të Agjencisë për të hequr dorë nga aseti. Për më tepër sipas nenit 8 të Ligjit nr. 04/L—147, për Ujërat e Kosovës, kjo rrjedhje mund të cilësohet si pasuri ujore artificiale. Bazuar në nenin 9, të Ligjit nr. 04/L—147, për Ujërat e Kosovës, për nevoja të interesit publik , pronaret ose poseduesit e tokave, dhe të resurseve ujore, mundë të kufizohen në shfrytëzimin e tyre . Nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës ta aprovoj kërkesën për heqje dorë nga aseti me sipërfaqe prej 7597 m², siç përshkruhet në certifikatën nr.(PRZ011-NBI Rahovec).

Kërkesës i ka bashkangjitur: Kopjen e vlerësimit/ përcaktimit të miratuar të gjendjes,(Raporti i gjendjes në teren) i datës 11.07.2022, raportin e gjendjes së Proceseve të Ndërmarrjes Shoqërore, kopjen e njoftimit mbi fillimin e procedurës së likuidimit dhe emërimit të anëtarëve të parë të Komisionit të Likuidimit , kopjen e njoftimeve për fillimin e procedurës së likuidimit, kopjen e vendimit për emërimin e autoritetit të likuidimit, kopjen e certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme (PRZ011-NBI Rahovec) të datës 16.08.2022, rekomandimin e autoritetit të likuidimit për Bordin e Drejtorëve për të hequr dorë nga aseti datë 16 gusht 2020, dhe vendimi nga ana e Bordit të Drejtorëve të datës 31.08.2022 për të hequr dorë nga aseti.

Arsyetimi ligjor

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës e jep pëlqimin për Agjencinë Kosovare e Privatizimit, Autoritetin e Likuidimit për N.SH “ NBI Rahoveci” Rahovec (në likuidim) Fi.492/89 për të hequr dorë nga aseti- ngastra ngastra nr. P- 71510033-01623-0 , me sipërfaqe 7597 m², zona kadastrale Xërxë, komuna e Rahovecit.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, ka juridiksion për të vendosur në bazë të nenit 5 të Ligjit nr. 06/L-086 i Dhomës së Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet

Numri i lëndës:
Datë:
Numri i dokumentit:



e Agjencisë Kosovare të Privatizimit për Ndërmarrjet apo Korporatat të cilat i nënshtrohen autoritetit administrativ të AKP-së .

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, vlerëson se për rastin konkret Agjencia Kosovare e Privatizimit- Autoriteti i Likuidimit në kërkesën e saj për aprovimin e lejes për të hequr dorë nga aseti ngastra nr. P- 71510033-01623-0 , me sipërfaqe 7597 m², zona kadastrale Xërxë, komuna e Rahovecit, ka caktuar zyrtaret e saj për të vizituar gjendjen faktike në teren lidhur me ngastrën lëndore, ka hartuar një raport me shkrim që është konstatuar se sipas certifikatës së pronës, ngastra 016523-0 me sipërfaqe 7597 m², me kulturë Rajon ujqor- Lum , dhe sipas gjendjes faktike në terren është rajon ujqor i lumit Drin. Raportit i ka bashkangjitur edhe fotografi për të pasqyruar gjendjen faktike të ngastrës.

Duke pasur parasysh gjendjen faktike të ngastrës -asetit, gjykata pranon qëndrimin e Bordit të AKP-së, se aseti nuk mund të jetë fitimprurës për NSH -në, pasi në gjendje aktuale që është ngastra, AKP nuk do të mund të gjejë ndonjë blerës apo që i njëjti të përdoret për realizim të hyrave në dobi të NSH-së, kështu që në rastin konkret Dhoma Posaçme e Gjykatës Supreme jep pëlqimin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit për heqje dorë nga ky aset, në dobi të autoritetit publik, Komuna e Rahovecit.

Me dispozitën e nenit 18, paragrafi 3, të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034, është paraparë “Autoriteti i Likuidimit , me leje të Gjykatës, mund të heq dorë apo në mënyra tjera të zgjidh cilindo nga asetet e ndërmarrjes në vijim :3.1 çdo aset problematik apo jo profitabil i cili, sipas mendimit të arsyeshëm të Autoritetit të Likuidimit , nuk është në gjendje të ketë realizim fitimprurës ,3.2 çdo aset që sipas mendimit të arsyeshëm të Autoritetit të Likuidimit nuk mund të ushtrohet kontroll efektiv nga ana e ndërmarrjes , Autoritetit të Likuidimit apo Gjykatës ”

Me rastin e dhënies së pëlqimit për heqje dorë nga aseti , gjykata vlerësoi se janë përmbushur kriteret që parasheh dispozita e nenit 18, paragrafi 3 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.

Për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Taksat gjyqësore

Parashtruesi i kërkesës, ka bërë pagesën e taksës gjyqësore dhe nuk caktohen taksa shtesë në këtë procedurë.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Lirije Maksutaj , Gjyqtar Kryesuese
Asllan Krasniqi, Gjyqtare anëtarë
Agron Hoxhaj, Gjyqtar anëtarë

